

## Sylabus: Hyrje në gramatikën e gjuhës gjermane

<b>Informatat themelore për lëndën</b>	
Njësia akademike:	<b>Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane</b>
Titulli i lëndës:	<b>Hyrje në gramatikën e gjuhës gjermane</b>
Niveli:	<b>BA</b>
Statusi i lëndës:	<b>Obligative</b>
Viti i studimeve:	<b>viti i I, semestri i I</b>
Numri i orëve në javë:	<b>2 + 2</b>
Kreditë ECTS:	<b>6 ECTS</b>
Koha / Vendi:	<b>Sipas orarit</b>
Mësimdhënësi:	<b>Prof. Asoc. Dr. Vjosa Hamiti</b>
Të dhënat kontaktuese:	<b>vjosa.hamiti@uni-pr.edu</b>
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë u ofron studentëve njohuri themelore mbi gjuhësinë gjermane dhe konceptet kryesore të gramatikës. Studentët do të familjarizohen me terminologjinë gramatikore, me pjesët e ligjëratës si dhe me funksionet dhe përdorimin e tyre në gjuhën gjermane.</p> <p>Lënda ndërtohet mbi një qasje të organizuar nga lart poshtë: nga njësitë më të mëdha gjuhësore drejt njësive më të vogla, duke ndjekur hierarkinë e strukturave gjuhësore. Përmes këtij organizimi, studentët do të zhvillojnë aftësinë për të kuptuar dhe analizuar sistemin gramatikor të gjuhës gjermane në mënyrë progresive.</p> <p>Një komponent i rëndësishëm i lëndës është kombinimi i teorisë me praktikën. Studentët jo vetëm që do të mësojnë konceptet teorike, por gjithashtu do të udhëzohen në aplikimin e tyre në ushtrime praktike, duke e bërë më të lehtë lidhjen midis njohurive teorike dhe përdorimit real të gjuhës.</p>

## Qëllimet e lëndës:

## Kjo lëndë synon:

- Të vetëdijësojë studentët për veçoritë themelore dhe aspektet e veçanta të sistemit gjuhësor.
- Të thellojë njohuritë e studentëve mbi konceptet bazë të gramatikës së gjuhës gjermane.
- T'i mësojë funksionet e të gjitha pjesëve të ligjëratës dhe përdorimin e tyre korrekt në praktikë.
- Të zgjerojë njohuritë gjuhësore dhe meta-gjuhësore të studentëve.
- Të motivojë studentët për të hulumtuar rregullat dhe rregullsitë gjuhësore, si një hap drejt zhvillimit të mendimit kritik dhe mësimit të pavarur.
- T'i aftësojë studentët të kuptojnë dhe të përdorin termat themelore të gramatikës së gjuhës gjermane dhe shqipe, duke i krahasuar ato për të mundësuar transferimin e njohurive dhe shkathësive.
- T'i pajisë studentët me aftësinë për të përshkruar dhe përdorur sistemin gjuhësor në mënyrë të vetëdijshme.
- T'i aftësojë studentët të monitorojnë progresin e tyre dhe të zhvillojnë teknika vetë-korrigjuese, duke kontribuar në ndërtimin e kompetencave për mësim gjatë gjithë jetës.

## Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të:

- Dallojë dhe identifikojë pjesët e ligjëratës në gjuhën gjermane.
- Përshkruajë aspektet kryesore të sistemit gjuhësor gjerman, duke përfshirë sintaksën, morfologjinë dhe rregullat e fjalëformimit.
- Përdorë terminologjinë bazë të gramatikës së gjuhës gjermane me vetëbesim dhe saktësi.
- Demonstrtojë një shkallë më të lartë të saktësisë në përdorimin praktik të gjuhës gjermane.

- Krahasojë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet sistemit gjuhësor të shqipes dhe atij gjerman.

### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtime	4	15	45
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	2	5	10
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	15	4
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	5	2	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.			
<b>Total</b>			<b>145.5 : 25=5.82 6 ECTS</b>

**Metodat e mësimdhënies:** Metodologjia e mësimdhënies do të jetë interaktive dhe e orientuar kah studenti. Puna individuale, puna në çift dhe puna në grup do të përdoren rregullisht, duke u mbështetur në materialet e trajtuara dhe në detyrat praktike. Pjesëmarrja aktive e studentëve është komponentë thelbësore për realizimin e objektivave të lëndës dhe për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit.

**Metodat e vlerësimit:** Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%.  
Vijueshmëria e studentit 10%;  
Detyrat individuale të kryera në klasë dhe shtëpi 10 %;  
Kollokfiumi I 40%  
Kollokfiumi II 40%

**Literatura primare:** **Ligjerata:**  
1. DUDEN 4 (2022): Die Grammatik. Mannheim. Wien. Zürich. Leipzig.

	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. Habermann, Mechtild/Diewald, Gabriele/ Thurnaur, Maria (2009) : DUDEN - Fit für das Bachelorstudium: Grundwissen Grammatik für Sprachstudiengänge</li> <li>3. Helbig/Buscha (2013): Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht. Leipzig.</li> <li>4. Ernst, Peter (2025) Deutsche Grammatik : eine Einführung in die Beschreibung der Gegenwartssprache. Wien, Österreich: Facultas.</li> <li>5. Hentschel, Elke/ Weydt, Harald (2013): Handbuch der deutschen Grammatik, Berlin.</li> </ol> <p><b><u>Ushtrime:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Helbig/Buscha (2002): Übungsgrammatik. Leipzig.</li> <li>2. Dreyer/Schmitt (2013): Lehr- und Übungsbuch der deutschen Grammatik, Neubearbeitung, Lehr- und Übungsbuch: 'Die neue Gelbe'. Neubearbeitung. Ismaning/München</li> </ol>
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zifonun,G/ Hoffmann,L / Stecker, B. , (1997): Grammatik der deutschen Sprache ,1, 2, 3 , Berlin/New York,</li> <li>2. Eisenberg, Peter(2013): Grundriss der deutschen Grammatik/Das Wort, Stuttgart</li> <li>3. Eisenberg, Peter(2013): Grundriss der deutschen Grammatik/Der Satz, Stuttgart</li> <li>4. Engel, Ulrich (2004): Deutsche Grammatik, München</li> <li>5. Karin Hall/Barbara Schneider (2013): Übungsgrammatik für Fortgeschrittene DaF. Ismaning/München.</li> </ol>

<b>Hartimi i planit mësimor</b>	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	<u>Das Wort:</u> Lexem und Wortform
Java 2:	<u>Was ist Grammatik?</u> -Zeichen, -Wortarten -Lexikalische und syntaktische Wortart -Flexion -Zur Abgrenzung von Flexion und -Wortbildung -Flexionsmittel
Java 3:	<u>Artikelwörter und Pronomen:</u> -Artikel- Abgrenzung als Wortklasse: -definitiver Artikel (bestimmter Artikel) der, die , das -indefinitiver Artikel (unbestimmter Artikel) ein, eine

	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Nullartikel</li> <li>- Wortstellung und Deklination</li> </ul>
Java 4:	<u>Artikelwörter und Pronomen:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Pronomen- Abgrenzung als Wortklasse (Gebrauch und Aufteilung)</li> <li>-Das Personalpronomen</li> <li>-Das Reflexivpronomen</li> <li>-Possessive Artikelwörter und Pronomen</li> <li>-Demonstrative Artikelwörter und Pronomen</li> <li>-Numeralien</li> </ul>
Java 5:	<u>Substantiv- Abgrenzung als Wortklasse:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Die Bedeutungsgruppen des Substantivs</li> <li>-Das Genus des Substantivs</li> <li>-Die Kasusflexion des Substantivs</li> </ul>
Java 6:	<u>Substantiv:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Der Numerus des Substantivs (Singular und Plural)</li> <li>-Zum Verhältnis von Numerus- und Kasusflexion Deklination</li> </ul>
Java 7:	<b><u>Erste Zwischenprüfung (Kolloquium 1)</u></b>
Java 8:	<u>Verb:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Morphologische Klassifikation</li> <li>-Semantische Klassifikation</li> <li>-Syntaktische Klassifikation</li> </ul>
Java 9:	<u>Verb- Konjugation im Indikativ:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Tempusystem im Deutschen</li> <li>-Synthetische Tempusbildung</li> <li>-Analytische Tempusbildung</li> </ul>
Java 10:	<u>Verb-Konjugation im Indikativ:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Vollverben: regelmäßige, unregelmäßige Verben</li> <li>-Hilfsverben</li> <li>-Mischverben</li> <li>-Rektion der Verben</li> </ul>
Java 11:	<u>Verb- Konjugation im Indikativ:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Bildung der Vergangenheitsformen mit <i>haben</i> und/ oder <i>sein</i></li> <li>-Transitive und intransitive Verben</li> <li>-Reflexive Verben</li> </ul>
Java 12:	<u>Verb- Konjugation im Indikativ:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Modalverben (Modifizierende Vb.)</li> <li>-Trennbare und untrennbare Verben</li> </ul>
Java 13:	<u>Verb- Imperativ:</u>

	-Gebrauch und Bildung
Java 14:	<u>Präpositionen- als Wortart:</u> -Entstehung -Stellung -Bedeutung und Funktion - Kasusreaktion -Verschmelzung von Präposition und Artikel
Java 15:	<u>Zweite Zwischenprüfung (Kolloquium 2)</u>

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijnë ligjëratat dhe ushtrimet rregullisht. Lejohen maksimumi **tri mungesa gjatë semestrit**; tejkalimi i këtij kufiri ndikon në pjesëmarrjen dhe vlerësimin final. Detyrat që dalin nga orët e mësimit janë të detyrueshme dhe përbëjnë pjesë integrale të vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime apo në punimet me shkrim ndalohen rreptësisht dhe trajtohen si shkelje serioze akademike. Në raste të tilla, studenti i nënshtrohet masave disiplinore sipas rregulloreve në fuqi të Universitetit të Prishtinës.